

SI TË BËHENI NËNSHTETAS GREK?

(Udhëzime të thjeshtuara rreth marrjes së nënshtetësisë greke)*

	KUSH NUK MUND TË APLIKOJË?	KUR MUND TA BËJ APLIKIMIN?	ÇFARË DOKUMENTESH NEVOJITEN?	KU TË APLIKOJ?	SA KUSHTON?	SA DUHET TË PRES PËR VENDIMIN, SIPAS LIGJIT?
Për shtetasit e vendeve jashtë BE-së	<ul style="list-style-type: none"> Ata që nuk kanë leje qëndrimi ose kanë vetëm leje të përkohshme Ata që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose dënime që janë më shumë se 1 vit për krime që janë kryer me dashje. 	<ul style="list-style-type: none"> Pas 7 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi me kusht që të jem martuar me një nënshtetas/e grek/e dhe të kem fëmijë me të. Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm nëse kam një fëmijë në moshë të mitur që ka nënshtetësi greke (nuk aplikohet për ata që e kanë fituar nënshtetësinë sepse kanë frekuentuar një shkollë greke) Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi, nëse jam refugjat ose jam pranuar si person pa nënshtetësi nga autoritetet greke. 	<ul style="list-style-type: none"> Një “deklaratë natyralizimi” pranë bashkisë së vendbanimit tim. Një aplikim për natyralizim Një leje qëndrimi e llojeve të mëposhtme si: <ul style="list-style-type: none"> a) Leje qëndrimi afatgjatë ose leje qëndrimi e brezit të dytë, b) për bashkëshortët/et e nënshtetasve grekë ose të BE-së, ose një prind i një nënshtetasi grek në moshë të mitur, c) një refugjat politik ose me mbrojtje të përkohshme, d) si person pa nënshtetësi Pasaporta Nëse kam lindur jashtë vendit, një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht/ Nëse kam lindur në Greqi, një certifikatë lindjeje greke. Auditimet e taksave personale për vitet e fundit. Numri i sigurimeve shoqërore (A.M.K.A.) Dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjet e mia me Greqinë dhe grekët 	Pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj	<ul style="list-style-type: none"> 700 euro për aplikimin për herë të parë 200 euro për aplikimin për herë të dytë dhe për të gjitha aplikimet vijuese 100 euro për aplikimin për herë të parë dhe për të gjitha aplikimet vijuese, nëse jam refugjat ose person pa nënshtetësi 	1 vit (në praktikë 2-4 vjet)

	KUSH NUK MUND TË APLIKOJË?	KUR MUND TA BËJ APLIKIMIN?	ÇFARË DOKUMENTESH NEVOJITEN?	KU TË APLIKOJ?	SA KUSHTON?	SA DUHET TË PRES PËR VENDIMIN, SIPAS LIGJIT?
Për shtetasit e vendeve të BE-së	<ul style="list-style-type: none"> • Ata që nuk kanë një certifikatë regjistrimi ose certifikatë qëndrimi të përhershëm të shtetasve të BE-së • Ata që kanë marrë dënime me burg prej më shumë se 6 muajsh, për lloje të caktuara krimesh, ose dënime prej më shumë se 1 viti për krime që janë kryer me dashje. 	Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi	<ul style="list-style-type: none"> • Një “Deklaratë natyralizimi” pranë bashkisë së vendbanimit tim. • Një aplikim për natyralizim • Certifikatë regjistrimi ose certifikatë qëndrimi të përhershëm të shtetasve të BE-së të nxjerrë nga departamentet e emigracionit të policisë greke • Pasaporta • Nëse kam lindur jashtë vendit, një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht/ Nëse kam lindur në Greqi, një certifikatë lindjeje greke • Auditimet e taksave personale për vitet e fundit. • Numri i sigurimeve shoqërore (A.M.K.A.) • Dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjet e mia me Greqinë dhe grekët 	Pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj	100 euro për aplikimin për herë të parë dhe për të gjitha aplikimet vijuese	1 vit (në praktikë 2-4 vjet)
Për grekët etnikë nga Shqipëria, Turqia dhe shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik, që kanë Kartën e Veçantë të Identitetit (EDTO)	<ul style="list-style-type: none"> • Ata që nuk kanë Kartën e Veçantë të Identitetit për grekët etnikë (EDTO) • Ata që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose më shumë se 1 vit për krime që janë kryer me dashje. • Ata që nuk kanë banim të përhershëm në Greqi 	Në çdo moment	<ul style="list-style-type: none"> • Një aplikim për natyralizim • Karta e Veçantë e Identitetit për grekët etnikë (EDTO) • Pasaporta • një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht • një certifikatë familjare (gjendja civile e familjes) e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht. 	Pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj	100 euro	1 vit (në praktikë 1-2 vjet)

	KUSH NUK MUND TË APLIKOJË?	KUR MUND TA BËJ APLIKIMIN?	ÇFARË DOKUMENTESH NEVOJITEN?	KU TË APLIKOJ?	SA KUSHTON?	SA DUHET TË PRES PËR VENDIMIN, SIPAS LIGJIT?
Për grekët etnikë që jetojnë në shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik	Ata që nuk janë grekë etnikë	Në çdo moment	<ul style="list-style-type: none"> Një aplikimi për natyralizim ose Karta e Veçantë e Identitetit për grekët etnikë (EDTO) Pasaporta Certifikata e lindjes së aplikuesit dhe e prindërve të tij, e vërtetuar dhe me përkthim zyrtar Certifikata e martesës e prindërve, e vërtetuar dhe me përkthim zyrtar Dokumente të tjera që vërtetojnë trashëgiminë time etnike greke (numri identifikues i rekrutimit në ushtri, certifikata e nënshtetësisë, pasaporta konsullore, dokumente të autoriteteve sovjetike që përmbajnë përcaktimin etnik etj.) 	Pranë zyrës konsullore greke, e mandatar për të shërbyer në zonën ku banoj	Asnjë tarifë	Nuk specifikohet
Për grekët etnikë nga shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik që janë vendosur në Greqi përpara 2 majit 2001, ose janë prindër apo fëmijë që e kanë fituar tashmë nënshtetësinë greke	Ata që kanë mbërritur në Greqi pas 2 majit 2001 dhe nuk janë prindër apo fëmijë të grekëve etnikë që kanë fituar nënshtetësinë greke	Në çdo moment	<ul style="list-style-type: none"> Një aplikim për natyralizim Pasaporta Certifikata e lindjes së aplikuesit dhe e prindërve të tij e vërtetuar dhe me përkthim zyrtar Certifikata e martesës e prindërve e vërtetuar dhe me përkthim zyrtar Vendimi për marrjen e nënshtetësisë greke të prindit tim (aplikohet për fëmijët e grekëve etnikë) dhe një certifikatë familjare e kohëve të fundit e prindit, nga bashkia ku është regjistruar Dokumente të tjera që vërtetojnë trashëgiminë time etnike greke (numri identifikues i rekrutimit në ushtri, certifikata e nënshtetësisë, pasaporta konsullore, dokumente të autoriteteve sovjetike që përmbajnë përcaktimin etnik etj.) 	Pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj	Asnjë tarifë	Nuk specifikohet

	KUSH NUK MUND TË APLIKOJË?	KUR MUND TA BËJ APLIKIMIN?	ÇFARË DOKUMENTESH NEVOJITEN?	KU TË APLIKOJ?	SA KUSHTON?	SA DUHET TË PRES PËR VENDIMIN, SIPAS LIGJIT?
Për personat që kanë një paraardhës etnik grek	Ata që kanë banim të përhershëm jashtë vendit dhe nuk mund të konsiderohen si grekë	Në çdo moment	<ul style="list-style-type: none"> • Një aplikim për natyralizim • Një "Deklaratë natyralizimi" përpara Konsullit • Dëshmi penaliteti (certifikatë e gjendjes gjyqësore) nga vendi im i origjinës, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht • Pasaporta • Certifikata e lindjes së aplikuesit e vërtetuar dhe me përkthim zyrtar • Dokumente që vërtetojnë lidhjen time me paraardhësin grek 	Pranë ambasadës ose konsullatës greke të zonës ku jetoj	120 euro (Kostoja mund të rritet në varësi të tarifave konsullore)	1 vit (në praktikë 1-2 vjet)
Për personat që kanë një paraardhës që ka qenë nënshtetas grek (përcaktimi/deklari mi i nënshtetësisë)		Në çdo moment	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i paraardhësit në regjistrat e bashkisë greke • Dokumente që vërtetojnë lidhjen time me paraardhësin grek 	Pranë Ambasadës Greke ose pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj	Nëse aplikimi dorëzohet pranë një ambassade greke, atëherë ka një tarifë konsullore prej 100 eurosh	18 muaj

	KUSH NUK MUND TË APLIKOJË?	KUR MUND TA BËJ APLIKIMIN?	ÇFARË DOKUMENTESH NEVOJITEN?	KU TË APLIKOJ?	SA KUSHTON?	SA DUHET TË PRES PËR VENDIMIN, SIPAS LIGJIT?
<p>Për personat që kanë frekuentuar një shkollë që implementon programin mësimor të detyrueshëm grek</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ata që nuk kanë leje qëndrimi ose kanë vetëm leje të përkohshme • Ata që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose më shumë se 1 vit për krime që janë kryer me dashje • Ata që kanë kryer 6 ose 9 vite shkolle kur kanë qenë të mitur dhe tani janë mbi 21 vjeç • Ata që kanë kryer 6 ose 9 vite shkolle pasi kanë mbushur 23 vjeç • Ata që kanë kryer 6 ose 9 vite shkolle pasi kanë mbushur 18 vjeç dhe përpara se të mbushin 23 vjeç, por kanë kaluar 3 vjet që prej përfundimit të studimeve • Kur kanë kaluar më shumë se 3 vjet nga data e diplomimit nga një universitet grek (AEI ose TEI). 	<p>Pasi kryej me sukses 9 vite shkollë në nivelin arsimor të ciklit të ulët dhe të mesëm të ulët, ose</p> <p>Pas kryerjes së 6 viteve shkollë në nivelin arsimor të ciklit të mesëm të ulët</p> <p>ose</p> <p>Pas diplomimit nga një shkollë e mesme greke (Lykio) dhe universitet grek (AEI ose TEI)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Deklarata – Aplikimi për marrjen e nënshtetësisë greke • Certifikata e frekuentimit të shkollës e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Arsimore e Ciklit të Ulët dhe të Mesëm të Ulët. • Leja e qëndrimit • Nëse kam lindur jashtë vendit, një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht. • Nëse kam lindur në Greqi, regjistrimi i lindjes në bashki. • Pasaporta • Një “Deklaratë solemne” opsionale për përshtatjen e emrit dhe mbiemrit tim në gjuhën greke. aplikohet vetëm për ata që janë mbi 18 vjeç dhe dëshirojnë ta bëjnë atë ndryshim. 	<p>Pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj</p>	<p>100 euro</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 6 muaj nëse jam nën moshën 18 vjeçare në kohën e dorëzimit të aplikimit (në praktikë 1 vit - 18 muaj) • 1 vit nëse jam mbi moshën 18 vjeçare në kohën e dorëzimit të aplikimit (në praktikë 1 vit - 18 muaj)

	KUSH NUK MUND TË APLIKOJË?	KUR MUND TA BËJ APLIKIMIN?	ÇFARË DOKUMENTESH NEVOJITEN?	KU TË APLIKOJ?	SA KUSHTON?	SA DUHET TË PRES PËR VENDIMIN, SIPAS LIGJIT?
Për ata që kanë lindur në Greqi dhe që kanë frekuentuar një shkollë që implementon programin mësimor të detyrueshëm grek	<ul style="list-style-type: none"> • Kur asnjë prej prindërve nuk ka leje qëndrimi ose kanë vetëm leje të përkohshme qëndrimi • Kur asnjë prej prindërve të të miturit nuk ka jetuar në Greqi për më shumë se 5 vjet me leje qëndrimi, përpara lindjes së të miturit, dhe as nuk ka jetuar në Greqi me leje qëndrimi për më shumë se 10 vjet në total, përpara dhe pas lindjes së të miturit. 	Nga regjistrimi në klasën e 1-rë të shkollës fillore.	<ul style="list-style-type: none"> • Deklarata – Aplikimi për marrjen e nënshtetësisë greke • Regjistrimi i lindjes në bashkinë greke. • Certifikata e martesës së prindërve, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht, ose nëse martesa është lidhur në Greqi, regjistrimi i martesës në bashki. • Lejet e qëndrimit të prindërve. Të paktën një prej prindërve duhet të ketë një prej lejeve të mëposhtme të lëshuara: për qëndrim afatgjatë, për brezin e dytë, për periudhë të pakufizuar, për 10 vjet, për refugjatët, për personat me statusin e mbrojtjes së përkohshme, për personat pa shtetësi dhe për nënshtetësit e BE-së • Pasaportat e prindërve, me përkthim zyrtar. • Certifikata e regjistrimit dhe e frekuentimit të fëmijës për klasën e 1-rë të shkollës fillore. Lëshohet nga Drejtori i Shkollës. 	Pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetoj	100 euro	6 muaj (në praktikë rreth 1 vit)

**Kodifikimi aktual i proceseve të nënshtetësisë është hartuar nga Avokati i Popullit i Greqisë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Nënshtetësinë pranë Ministrisë së Brendshme. Është një përmbledhje e legjislacionit përkatës dhe për këtë arsye nuk përfshin të gjitha rastet e veçanta, përjashtimet dhe rregulloret e përkohshme që ekzistojnë. Për më shumë informacion duhet të kontaktoni Drejtoritë lokale të Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar*